REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	03.10.2026
Nr.	2203 prot.

KËRKESË

KËRKUES: **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

Ilirjan CELIBASHI,

OBJEKTI: Vendosja e sanksioneve administrative ndaj partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat "ë" e "n", nenit 21, pika 1, shkronja "dh", nenit 78, nenit 84, pikat 5, 6 e 9, nenit 88, pika 7, nenit 90, pikat 3 e 4, nenit 92/3, nenit 92/6, nenit 92/7, nenit 171, pika 1, nenit 173, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 8, " Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimi nr. 12, datë 27.2.2025, i Komisionit Rregullator, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 13, datë 6.4.2021, të Komisionit Rregullator, "Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore, vendimit nr. 34, datë 28.8.2025, të Komisionit Rregullator, "Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvend, të datës 11 Maj 2025".

Përpara:

Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve

Në zbatim të detyrimeve ligjore që burojnë nga Kodi Zgjedhor, subjektet zgjedhore kanë detyrimin të deklarojnë dhe të bëjnë transparente burimet e financimit dhe shpenzimet e kryera gjatë fushatës

zgjedhore, në përputhje me afatet, mënyrën, formatin dhe kërkesat e përcaktuara në legjislacionin zgjedhor dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

Në mbështetje të nenit 21, pika 1, shkronja "dh", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, me kërkesë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është kompetent për vendosjen e sanksioneve administrative ndaj personave, subjekteve zgjedhore dhe/ose kandidatëve të tyre për kundërvajtjet administrative në lidhje me zgjedhjet.

Në përmbushje të funksioneve të tij ligjore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ushtron kontrollin dhe verifikimin e financimit të fushatës zgjedhore, ndër të tjera, nëpërmjet auditimit të raporteve financiare të subjekteve zgjedhore.

Në zbatim të nenit 92/3 të Kodit Zgjedhor, subjektet zgjedhore kishin detyrimin për të dorëzuar raportet financiare të fushatës jo më vonë se 60 ditë nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

Në vijim të përfundimit të procesit të kontrollit dhe auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzimeve të kryera nga subjektet zgjedhore, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me Vendimin nr. 49, datë 23.7.2026, "Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025", miratoi raportin përfundimtar të gjetjeve të auditimit.

Nga shqyrtimi i gjetjeve të evidentuara në raportin e auditimit rezultojnë raste të mosrespektimit nga subjektet zgjedhore të detyrimeve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij, lidhur me raportimin financiar, si dhe kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore.

Shkeljet e konstatuara janë të dokumentuara në raportin e auditimit dhe, në varësi të natyrës dhe rëndësisë së tyre, përbëjnë kundërvajtje administrative të parashikuara dhe të sanksionueshme sipas nenit 173 të Kodit Zgjedhor.

Për rrjedhojë, bazuar në gjetjet e auditimit dhe në dokumentacionin provues të administruar gjatë këtij procesi, vlerësohet se ndaj subjekteve zgjedhore të sipërcituara duhet të propozohet vendosja e sanksioneve administrative, sipas përcaktimeve të nenit 173, të Kodit Zgjedhor.

I. Vlerësimi juridik

Detyrimet e subjekteve zgjedhore në drejtim të transparencës së financimit të fushatës zgjedhore, deklarimit të burimeve të financimit, raportimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe respektimit të rregullave të përcaktuara për kontrollin dhe verifikimin e tyre, burojnë drejtpërdrejt nga dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

Këto detyrime kanë karakter të detyrueshëm dhe synojnë garantimin e transparencës së financimit të fushatës zgjedhore, kontrollueshmërinë e burimeve financiare të subjekteve zgjedhore dhe respektimin e parimeve të barazisë dhe integritetit të procesit zgjedhor.

Në këtë kuadër, mosrespektimi i detyrimeve ligjore për raportimin financiar, deklarimin e fondeve dhe shpenzimeve, si dhe detyrimeve të tjera të lidhura me kontrollin dhe verifikimin financiar, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor dhe, kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji, kundërvajtje administrative të sanksionueshme.

Në rastin konkret, gjetjet e evidentuara nga procesi i auditimit, të miratuara me Vendimin nr. 49, datë 23.7.2026, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, evidentojnë shkelje konkrete të detyrimeve të sipërcituara nga subjektet zgjedhore, për të cilat Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka propozuar masat konkrete për secilën nga subjektet.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 57 datë.04.09.2026, "Për një ndryshim në vendimin nr. 49, datë 23.7.2026 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025", ka vendosur ndryshimin e masës së gjobës për partinë politike "Partia Bashkimi Liberal Demokrat" nga masa 2 000 000 (dy milionë) lekë, në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

II. Subjektet zgjedhore ndaj të cilave propozohen sanksionet administrative

Në bazë të natyrës së shkeljeve të evidentuara në raportin e auditimit dhe në zbatim të nenit 173 të Kodit Zgjedhor, subjektet zgjedhore ndaj të cilave kërkohet vendosja e sanksioneve administrative janë si vijon:

1. **"Partia Bashkimi Liberal Demokrat"** – gjobë në masën **500 000 (pesëqind mijë) lekë**, sipas nenit 173, pika 3, të Kodit Zgjedhor;
2. **"Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare"** – gjobë në masën **2 000 000 (dy milionë) lekë**, sipas nenit 173, pika 3, të Kodit Zgjedhor;
3. **"Partia Aleanca Arbnore Kombëtare"** – gjobë në masën **2 000 000 (dy milionë) lekë**, sipas nenit 173, pika 3, të Kodit Zgjedhor;
4. **"Partia Aleanca Demokracia e Re"** – gjobë në masën **500 000 (pesëqind mijë) lekë**, sipas nenit 173, pika 3, të Kodit Zgjedhor;
5. **"Partia Aleanca Konservatore për Shqipërinë"** – gjobë në masën **500 000 (pesëqind mijë) lekë**, sipas nenit 173, pika 3, të Kodit Zgjedhor;
6. **"Partia Kristian Demokrate"** – gjobë në masën **500 000 (pesëqind mijë) lekë**, sipas nenit 173, pika 3, të Kodit Zgjedhor;
7. **"Partia Balli Kombëtar"** – gjobë në masën **100 000 (njëqind mijë) lekë**, sipas nenit 173, pika 1, të Kodit Zgjedhor;

8. **"Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut"** – gjobë në masën **100 000 (njëqind mijë) lekë**, sipas nenit 173, pika 1, të Kodit Zgjedhor;
9. **"Partia Djathtas 1912"** – gjobë në masën **100 000 (njëqind mijë) lekë**, sipas nenit 173, pika 1, të Kodit Zgjedhor;
10. **"Partia Socialdemokrate"** – gjobë në masën **100 000 (njëqind mijë) lekë**, sipas nenit 173, pika 1, të Kodit Zgjedhor;
11. **"Partia Nisma Thurje"** – gjobë në masën **100 000 (njëqind mijë) lekë**, sipas nenit 173, pika 1, të Kodit Zgjedhor;
12. **"Partia Lëvizja Atdheu"** – gjobë në masën **500 000 (pesëqind mijë) lekë**, sipas nenit 173, pika 3, të Kodit Zgjedhor;
13. **"Partia Aleanca Kombëtare Shqiptare"** – gjobë në masën **500 000 (pesëqind mijë) lekë**, sipas nenit 173, pika 3, të Kodit Zgjedhor.

III. Provat dhe dokumentacioni mbështetës

Në mbështetje të kësaj kërkese dhe për të provuar shkeljet e konstatuara, si dhe për të justifikuar sanksionet administrative të propozuara, paraqiten dhe administrohen këto dokumente:

1. Vendimi nr. 49, datë 23.7.2026, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025";
2. Vendimi nr.57 datë 04.07.2026, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për një ndryshim në vendimin nr. 49, datë 23.7.2026 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025";
3. Raporti mbi gjetjet nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.

Dokumentacioni i sipërcituar përmban gjetjet konkrete të auditimit, shkeljet e konstatuara për secilin subjekt zgjedhor, si dhe elementet mbi të cilat mbështetet propozimi për vendosjen e sanksioneve administrative.

IV. Propozimi

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 173 të Kodit Zgjedhor, kërkoj nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, shqyrtimin e këtij propozimi për vendosjen e sanksioneve administrative ndaj subjekteve zgjedhore si më poshtë vijon:

1. Vendosjen e gjobës në masën **2 000 000 (dy milionë) lekë** ndaj "Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare";
2. Vendosjen e gjobës në masën **2 000 000 (dy milionë) lekë** ndaj "Partia Aleanca Arbnore Kombëtare";

3. Vendosjen e gjobës në masën **500 000 (pesëqind mijë) lekë** ndaj "Partia Bashkimi Liberal Demokrat";
4. Vendosjen e gjobës në masën **500 000 (pesëqind mijë) lekë** ndaj "Partia Aleanca Demokracia e Re";
5. Vendosjen e gjobës në masën **500 000 (pesëqind mijë) lekë** ndaj "Partia Aleanca Konservatore për Shqipërinë";
6. Vendosjen e gjobës në masën **500 000 (pesëqind mijë) lekë** ndaj "Partia Kristian Demokrate";
7. Vendosjen e gjobës në masën **500 000 (pesëqind mijë) lekë** ndaj "Partia Lëvizja Atdheu";
8. Vendosjen e gjobës në masën **500 000 (pesëqind mijë) lekë** ndaj "Partia Aleanca Kombëtare Shqiptare"
9. Vendosjen e gjobës në masën **100 000 (njëqind mijë) lekë** ndaj "Partia Balli Kombëtar";
10. Vendosjen e gjobës në masën **100 000 (njëqind mijë) lekë** ndaj "Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut";
11. Vendosjen e gjobës në masën **100 000 (njëqind mijë) lekë** ndaj "Partia Djathtas 1912";
12. Vendosjen e gjobës në masën **100 000 (njëqind mijë) lekë** ndaj "Partia Socialdemokrate";
13. Vendosjen e gjobës në masën **100 000 (njëqind mijë) lekë** ndaj "Partia Nisma Thurje";

IV.I **Argumentimi**:

Nga raporti "Mbi gjetjet nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025", rezulton se:

- "Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare" nuk ka dorëzuar raport financiar për fondet e përfituara dhe shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore.
- "Partia Aleanca Arbnore Kombëtare", nuk ka dorëzuar raport financiar për zgjedhjet e datës 11 Maj 2025;

Për këtë arsye KSHZ, në përputhje me nenin 173, pika 3, të Kodit Zgjedhor propozon vendosjen e gjobës në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë për secilën nga partitë e sipërcituara.

Rezulton se:

- "Partia Bashkimi Liberal Demokrat" ka dorëzuar raportin jashtë afatit ligjor për fushatën zgjedhore.
- "Partia Alenca Demokracia e Re", ka dorëzuar raportin jashtë afatit ligjor, problem teknik i sistemit PERF. Gjithashtu, 186 kandidatë të listave shumemërore nuk kanë dorëzuar raport financiar individual.
- "Partia Aleanca Konservatore për Shqipërinë", ka dorëzuar raportin jashtë afatit ligjor, problem teknik i sistemit PERF. Gjithashtu, 1 kandidat i listave shumemërore nuk ka dorëzuar raport financiar individual.
- "Partia Kristian Demokrate" ka dorëzuar jashtë afatit ligjor, problem teknik i sistemit PERF.
- "Partia Lëvizja Atdheu", 186 kandidatë të listave shumemërore nuk kanë dorëzuar raport financiar individual , shkelje e detyrimeve ligjore të transparencës.

- "Partia Aleanca Kombëtare Shqiptare", dhurimet e fondeve jo-publike janë bërë si nëpërmjet llogarisë së posaçme të fushatës, ashtu edhe nëpërmjet llogarisë rrjedhëse të aktivitetit të përditshëm të partisë, keqpërdorim i ndarjes legale. Gjithashtu, 186 kandidatë të listave shumemërore nuk kanë dorëzuar raport financiar individual që përbën shkelje e detyrimeve ligjore të transparencës.

Për këtë arsye KSHZ, në përputhje me nenin 173, pika 3, të Kodit Zgjedhor propozon vendosjen e gjobës në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë për secilën nga partitë e sipërcituara.

Rezulton se:

- "Partia Balli Kombëtar" , ka paraqitur shpenzimet pa dokumentacionin mbështetës të njohur nga ligji. Gjithashtu, transaksionet nuk janë kryer nëpërmjet llogarisë së posaçme të fushatës zgjedhore, siç kërkohet nga Kodi Zgjedhor. Gjithashtu, subjekti ka NIPT Pasiv dhe, në bazë të ligjit, nuk ka të drejtë të ushtrojë aktivitet ekonomik apo zgjedhor.

- "Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut", ka kaluar nga llogaria rrjedhëse e partisë 2.000.000 lekë në llogarinë e posaçme të fushatës me përshkrim 'kalim fondi', shumë e cila nuk është pasqyruar në raportin financiar. Gjithashtu, në raportin financiar nuk është deklaruar transferta bankare prej 1.500.000 lekësh kaluar në favor të Partisë Demokratike për shpenzime të fushatës koalicioni. Gjithashtu, nuk është kthyer e gjithë shuma e tërhequr nga z. Dule nga llogaria e posaçme , mbetet diferenca 59.000 lekë e pa-rakorduar. Gjithashtu, kandidati z. Petraq Gjikuria ka kryer shkelje të nenit 173, pika 3, të Kodit Zgjedhor, paraqitje raportesh në shkelje të formateve të standardizuara.

- "Partia Djathtas 1912", kandidatët nuk kanë paraqitur si të ardhura vlerat e vetëfinancimit të deklaruara, në shumën totale 1.224.005,60 lekë. Gjithashtu, kandidatët kanë raportuar si shpenzime vlera që nuk shoqërohen me fatura fiskale, në vlerën totale 1.165.998 lekë. Gjithashtu, raporti financiar ka mungesë rakordimesh, vlerat analitike individuale të kandidatëve nuk rakordojnë me raportet përmbledhëse as për qarqet e veçanta, as për totalin.

- "Partia Socialdemokrate", ka bashkangjitur si dokumente justifikuese fatura elektronike pa NIPT-in e PSD-së, në vlerën totale 218.341 lekë (2,39% e totalit të shpenzimeve cash). Gjithashtu, nuk janë paraqitur shpenzime për zyrat zgjedhore të raportuara nga monitoruesit, mungon dokumentacioni mbështetës. Nuk janë raportuar si shpenzime qiratë e zyrave elektorale për periudhën 1.1.2025–15.5.2025, sipas kontratave të bashkëngjitura raportit, në vlerën 760.352 lekë. Nuk janë paraqitur të dhënat për fondet e krijuara dhe shpenzimet e kryera nga vetë kandidatët, në vlerën 718.218 lekë. Gjithashtu, nga monitoruesit u konstatuan 8 zyra zgjedhore aktive, ndërkohë që raporti financiar deklaron shpenzime për 24 zyra.

- "Partia Nisma Thurje", subjekti nuk ka llogari bankare të posaçme të hapur për zgjedhjet, siç kërkohet nga neni 88 i Kodit Zgjedhor. Gjithashtu, shpenzimet dhe të ardhurat e fushatës janë dubluar për shumën 1.727.331 lekë sipas gjetjeve të auditimit, gabim i rëndë aritmetik/kontabël. Gjithashtu, në raportin financiar nuk janë plotësuar të dhënat e dhuruesve (numri i identifikimit dhe adresa).

Për këtë arsye KSHZ, në përputhje me nenin 173, pika 1, të Kodit Zgjedhor, propozon vendosjen e gjobës në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë për secilën nga partitë e sipërcituara.

Bashkëlidhur:

1. Vendimi nr. 49, datë 23.7.2026, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
2. Vendimi nr. 57, datë 04.09.2026, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
3. Raporti mbi gjetjet nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI